



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

**Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Korrik 2025**

**Data 25.07.2025 ora 13:00.**

**Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.**

**Rendi i dites:**

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 26.06.2025, si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.
- 2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Qershor 2025
- 3.Projekt vendim për Rishikim i VKB Nr.45 datë 13.06.2023 për: Miratimin e anëtarit të ri të Këshillit të Qarkut për shkak të krijimit të vakancës si pasojë e humbjes së mandatit të anëtarit të mëparshëm
- 4.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes të shtetasit Anton Gjergj Jera i dëmtuar nga zjarri me datë 13.06.2025, banorë i Bashkisë Vau Dejës.
- 5.Projekt vendim për miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor të sipëfaqes 25.7 ha në gastren nr.14 ekonomia pyjore Drin Gjader Kir.
- 6.Projekt vendim për miratimin e tavaneve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Vau Dejës
- 7.Të ndryshme.

Grupe interesi nuk ka të pranishëm , votimet do bëhen të hapura, për piken nr.3 votimi do bëhet i fshehtë.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes u zhvillua me datë 25.07.2025 ora 13.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.Të pranishëm në sallë ishin 16 këshilltarë, (Ervis Shimaj, Neki Kapllanaj,Franga Kola, Frano Prenga, Ornela Lleshi, Rregjinë Shelqetja, ,Mirela Vasija, Albinë Livadhi, Vjollcë Zagani, Sanije Salja, Besmir Kapaj, Edona Molla,Kastriot Shkjau,Arsen Mehmeti,Martin Mardoda,Gjovana Corri ). korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj -kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës.Rendi i ditës u miratua me 16 vota Pro.Këshilltarët që votuan pro:( Ervis Shimaj, Neki Kapllanaj,Franga Kola, Frano Prenga, Ornela Lleshi, Rregjinë Shelqetja, ,Mirela Vasija, Albinë Livadhi, Vjollcë Zagani, Sanije Salja, Besmir Kapaj, Edona Molla,Kastriot Shkjau,Arsen Mehmeti,Martin Mardoda,Gjovana Corri )



**Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:**

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 26.06.2025 si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 26.06.2025 nga Z.Ervis Shimaj. Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij. Këshilltarët që votuan pro: ( Ervis Shimaj, Neki Kapllanaj, Franga Kola, Frano Prenga, Ornela Lleshi, Rregjinë Shelqetja, Mirela Vasija, Albinë Livadhi, Vjollcë Zagani, Sanije Salja, Besmir Kapaj, Edona Molla, Kastriot Shkjau, Arsen Mehmeti, Martin Mardoda, Gjovana Corri )

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:**

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Qershor 2025

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike,e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se projekt vendimi është hartuar bazuar ne ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për Përcaktimin e Procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike", të ndryshuar, Si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 02, datë 27.01.2025, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025"; Shkresën e Prefekturës së Qarkut Shkodër për shprehje ligjshmërie nr. 106/1 prot, datë 11.02.2025.

Ajo shprehet se bazuar ne fondet e kushtëzuara për muajin Qershor 2025 , të përfitojnë 137 familje me 439.174 lekë, me 5.98% e fondit total.Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Qershor 2025 janë shpallur fitues, 955 familje, me fond 7.328.326 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 439.699 lekë.

Z.Ervis Shimaj spjegon se komisioni i K.Bashkiak ka propozuar miratimin e projekt vendimit.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

**Miratohet me 16 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.** Këshilltarët që votuan Pro piken e dytë të rendit të ditës :( Ervis Shimaj, Neki Kapllanaj,Franga Kola, Frano Prenga, Ornela Lleshi, Rregjinë Shelqetja, Mirela Vasija, Albinë Livadhi, Vjollcë Zagani, Sanije Salja, Besmir Kapaj, Edona Molla,Kastriot Shkjau,Arsen Mehmeti,Martin Mardoda,Gjovana Corri )

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Projekt vendim për Rishikim i VKB Nr.45 datë 13.06.2023 për: Miratimin e anëtarit të ri të Këshillit të Qarkut për shkak të krijimit të vakancës si pasojë e humbjes së mandatit të anëtarit të mëparshëm.

Z.Ervis Shimaj sqaron këshilltarët se si pasojë e vakances së krijuar nga humbja e mandatit të këshilltres Znj.Kristjan Kovaçi, e cila ka qenë edhe anëtare e Këshillit të Qarkut Shkodër, duhet të zhvillojmë procesin e zgjedhjes së anëtarit të ri si përfaqesues në Këshillin e qarkut.Duhet të ruhet raporti gjinor në përfaqesim.Z.Ervis Shimaj fton kryetarët e grupeve që të bëjnë propozimet me më shumë se një kandidat.

Në emër të grupit të këshilltarëve të Partisë Socialiste, Z.Neki Kapllanaj propozon Znj.Franga Kola si kandidaturë të vetme.

Në emër të grupit të këshilltarëve të Partisë Socialdemokrate, Znj.Ornela Lleshi, deklarohet se nuk propozojmë kandidaturë.

Po kështu edhe nga grupi i Partisë Demokratike dhe koalicionit B.F, nuk kishte propozime nga këshilltarët prezent.

Z.Ervis Shimaj sqaron se votimi do bëhet u fshehtë me kandidaturë të vetme Znj.Franga Kola.

Menaxhimin e procesit të votimit e bëri komisioni i ngritur me datë 13.06.2023, me Kryetar Z.Frano Prenga,Sekretar Znj.Sanije Salja dhe Anëtar, Znj.Ornela Lleshi.

Pas procesit të votimit, komisioni shpall fitues Znj.Franga Kola me 16 vota Pro, zero vota kundër dhe zero vota abstenim, e cila zgjidhet si përfaqesuese e Këshillit Bashkiak Vau Dejës,në Këshillin e Qarkut Shkodër.

Këshilltarët që moren pjesë në votim: ( Ervis Shimaj, Neki Kapllanaj,Franga Kola, Frano Prenga, Ornela Lleshi, Rregjinë Shelqetja, Mirela Vasija, Albinë Livadhi, Vjollcë Zagani, Sanije Salja, Besmir Kapaj, Edona Molla,Kastriot Shkjau,Arsen Mehmeti,Martin Mardoda,Gjovana Corri )

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:**

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes të shtetasit Anton Gjergj Jera i dëmtuar nga zjarri me datë 13.06.2025, banorë i Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin Znj.Valjeta Nikaj- përgjegjëse e zyrës emergjencave civile, Bashkia Vau Dejës, e cila relatton për këshilltarët se projekt vendimi është hartuar në bazë të ligjit dhe i propozon Këshillit 1-Të miratojnë kërkesën e Bashkisë Vau Dejës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së z.Anton Gjergj Jera (5 anëtarë në familje), në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për dëmtimin pjesësisht të banesës së tij nga zjarri.

2. Të miratojnë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Vau Dejës, për familjen e z. Anton Gjergj Jera në vlerën totale të dëmit 1.455.973 (një milion e katërqind pesëdhjetë e pesë mijë e nentëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

3. Të miratojnë dhënien e kompensimit sipas proces verbalit të vlerësimit i hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në masën 50% të vlerës totale në shumën 727.986 (shtatëqind njëzet e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë.

Burimi i financimit do të jetë fondi i Bashkisë i planifikuar për Mbrojtjen Civile i miratuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.84 dt.23.12.2024 "Mbi mjetimin e buxhetit 2025" konfirmuar nga Prefektura Shkodër me shkresën 860/1 dt.06.01.2025.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët për pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në projekt vendimin:

**Miratohet me 16 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.** Këshilltarët që votuan Pro piken e katërt:(Ervis Shimaj, Neki Kapllanaj,Franga Kola, Frano Prenga, Ornella Lleshi, Rregjinë Shelqetja, Mirela Vasija, Albinë Livadhi, Vjollcë Zagani, Sanije Salja, Besmir Kapaj, Edona Molla,Kastriot Shkja, Arsen Mehmeti,Martin Mardoda,Gjovana Corri )

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e pestë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor të sipërfaqes 25.7 ha në ngastren nr.14 ekonomia pyjore Drin Gjader Kir.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Z.Mark Suli- inxhinjer specialist pranë zyres pyjeve Bashkia Vau Dejës, i cili relatton për këshilltarët se në mbështetje të ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ndryshuar, neni 9 pika 1/2,germa a, neni 54 shkronja "e/1" (ndryshuar), neni 55 pika 3, neni 27 pika 5, neni 64 pika c, neni 5 ligji nr 57/2020, për pyjet, pika 49, shtojca 47, të VKM nr.433 date 08.06.2016 „Për transferimin në pronë të Bashkive, pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventareve“ i ndryshuar, VKM nr.888 datë 27.12.2022 për rastet e dhenies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacionin përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakesimin në volum nga fondi pyjor kombëtar, apo zgjerimin e tyre, kapitulli II pika 5 dhe 6, VKM nr.599 date 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenie në shfrytëzim /përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike dhe për drusore dhe jodrusore pyjore“ Bashkia ka propozuar heqjen nga fondi pyjor sipërfaqen prej 25.7 ha dhe pas marrjes së vendimit nga K.B dhe pas daljes së VKM për heqje nga fondi pyjor, shoqëria kryen pagesën prej 51.834 lekë në total.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët për pyetje apo diskutime.

Z.Martin Mardoda-këshilltarë, pyet: Pse duhet ta heqim nga fondi pyjor këtë sipërfaqe?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Z.Mark Suli përgjigjet:Subjekti që e kërkon këtë sipërfaqe, kryen aktivitet minerar dhe ka leje minerare dhënë nga MIE si dhe leje mjedisi.

Këshilltarët e tjerë nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në projekt vendimin:

Vota Pro - (0-Zero), vota kundra - (14-katërmbëdhjet, këshilltarët që votuan kundra: Ervis Shimaj, Neki Kapllanaj,Franga Kola, Frano Prenga, Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Albinë Livadhi, Vjollcë Zagani, Sanije Salja, Besmir Kapaj, Edona Molla, Arsen Mehmeti,Martin Mardoda,Gjovana Corri, vota abstenim - (1-Kastriot Shkjau), Znj. Rregjina Shelqetja nuk mori pjesë në votim.**Nuk Miratohet.**

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e gjashtë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për miratimin e tavanëve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Vau Dejës

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Elsa Tanushi përgjegjëse e zyrës financë buxhetit Bashkia Vau Dejës e cila relatoi se jemi në fazën e miratimit të tavanëve buxhetore për 2026-2028. Kategoritë e taksave dhe tarifave që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave nga burimet e veta për vitet 2026-2028 janë kryesisht taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 26%, taksa e mjeteve të përdorura që zë rreth 12%, tarifa për pastrimin që zë rreth 21%, tarifa e ndriçimit publik që zë rreth 5%, tarifa të tjera ku përfshihen tarifatat nga institucionet kulturore dhe tarifa administrative zëzë rreth 20%. Këto zëra kryesorë mbulojnë rreth 83% të planit të të ardhurave të Bashkisë Vau Dejes.Të gjithë jeni pajisur me materialin dhe nëse keni pyetje apo diskutime mund ti drejtoni.

Z.Ervis Shimaj sqaron se për këtë pikë të rendit të ditës, është mbledhur Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe ka propozuar miratimin e projekt vendimit.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët për pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në projekt vendimin:

**Miratohet me 16 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.** Këshilltarët që votuan Pro piken e gjashtë:(Ervis Shimaj, Neki Kapllanaj,Franga Kola, Frano Prenga, Ornela Lleshi, Rregjinë Shelqetja, ,Mirela Vasija, Albinë Livadhi, Vjollcë Zagani, Sanije Salja, Besmir Kapaj, Edona Molla,Kastriot Shkjau,Arsen Mehmeti,Martin Mardoda,Gjovana Corri )

**Pika 7 Të ndryshme:**

Z.Martin Mardoda pyet:aka kaluar çdo muaj shpërblimi i 6% sepse më janë ankuar disa përfitues se nuk kanë kaluar të gjithë muajt.

Znj.Elsa Tanushi përgjigjet: Deri tani ne si zyre finance i kemi kaluar të gjithë muajt që janë miratu.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbledhjen e radhës e datës 25.07.2025 deklarohet e mbyllur nga kryetari Këshillit pasi nuk kishte pyetje apo diskutime tjera.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA



Këshilltarët:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. <u>Feris Shim</u>        | 16. <u>Mirela Vasije</u> |
| 2. <u>Nela Kopljanc</u>     | 17. _____                |
| 3. <u>Enigma Kalo</u>       | 18. _____                |
| 4. <u>Franco Preupo</u>     | 19. _____                |
| 5. <u>Omela Lleshi</u>      | 20. _____                |
| 6. <u>Hastriat Shkija</u>   | 21. _____                |
| 7. <u>Rugjime Shelqetja</u> | 22. _____                |
| 8. <u>Gjovana Corin</u>     | 23. _____                |
| 9. <u>Eolona Molla</u>      | 24. _____                |
| 10. <u>Allina Livadhi</u>   | 25. _____                |
| 11. <u>Myllke Zogdaj</u>    | 26. _____                |
| 12. <u>Bosmin Kapaj</u>     | 27. _____                |
| 13. <u>Saenja Sopi</u>      | 28. _____                |
| 14. <u>Martin Maripol</u>   | 29. _____                |
| 15. <u>Arsen Mehmeti</u>    | 30. _____                |
|                             | 31. _____                |